



REPUBLIKA E SHQIPËRIË

BASHKIA TIRANË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Objekti i Procedurës: objekt: “Blerje orendi dhe pajisje zyre”,

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (CPV): 33193120-6/ 39290000-1.

Vlera e Fondit Limit: 2,908,125 (dymilion e nëntëqind e tetëmijë e njëqind e njëzet e pesë) lekë pa T.V.SH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

c. *Formulari i ofertes sipas Shtojcës 1;*

ç. *Lista e cmimeve të artikujve sipas Shtojcës 2.*

Argumentimi: Kriteret e mesiperme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertes”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të nenit 26, dhe të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, i ndryshuar: citojmë Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP 1“. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave,

autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prove paraprake në vend të disa vërtetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Referuar pikës 1 të shtojcës 7, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, si dhe shtojcës 8 të DST-së.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare një vlerë jo më të vogël se 40% të vlerës së fondit limit lëshuar nga autoriteti përkatës. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kjo vlerë për xhiron vjetore është kërkuar pasi vlera e parashikuar e kontratës, është nën kufirin e ulët monetar. Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të LPP, si dhe nenin 40, neni 43 dhe neni 55 pika 4, të V.K.M Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, si dhe në legjislacionin e fushës në fuqi, përkatësisht në Ligjin Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, V.K.M Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe në Udhëzimin e Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar. "Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: 40 % të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar ...". Kjo procedurë është nën kufirin e ulët monetar dhe për këtë arsye, vlera e xhiros minimale të kërkuar, është brenda kufirit të parashikuar në dispozitat ligjore të sipërcituara.

2.2.2 Vetëdeklarim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2024, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar.

Kjo kerkese do te konsiderohet e permbushur gjate fazes se ofertimit me plotesimin e formularit te vetedeklarimit. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor do ti kërkojë ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve të deklaruar si më lart.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në nenin 77, pika 3, e LPP, nenin 43, pika 6, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe ligjin Nr.9920 date 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, dhe në ligjin Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar.

Ky kriter shërben për të garantuar Autoritetin Kontraktor se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, kanë kapacitetet e duhura ekonomike dhe financiare si dhe janë të përshtatshëm për të kryer veprimtari profesionale. Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2024 sipas kësteve pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin Nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë si dëshmi vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, neni 55, pika 4/b, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë: Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben Autoritetit Kontraktor për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në vlerë jo më të vogël se 20 % të fondit limit, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë

duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të disponojë të paktën 5 (pesë) punonjës të punësuar, të cilët duhet të figurojnë në listpagesen e fundit të shoqërisë të deklaruar nga data e hapjes së ofertave vërtetuar me:

- Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për periudhën e fundit të deklaruar.
- Listpagesat e punonjesve të konfirmuara nga autoritetet përkatëse sipas formatit që kërkohej nga legjislacioni në fuqi për periudhën e fundit të deklaruar, shoqëruar me formularët e deklarimit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shendetesore.

(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetedeklarimit, këto dokumente do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimit).

Argumentimi: Kërkesa është hartuar në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, Neni 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”, pika 5 “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj dhe/ose c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit...”, si dhe pika 8 “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”. Rrjedhimisht mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumentacion lidhur me këto kërkesa. Në këtë kontekst, referuar natyrës, vlerës së kontratës dhe objektit të prokuruar autoriteti kontraktor me anë të kërkesës së tij si më lart, e cila është vendosur në përputhje me specifikimet teknike për këtë procedurë, kërkon të garantohet për besueshmërinë, cilësinë dhe kapacitetet e operatorëve ekonomikë ofertues. Ky kriter lidhet gjithashtu me kapacitetet teknike dhe aftësitë profesionale të operatorëve. Duke marrë shkas nga fakti që tipi i kontratës është blerje mallra, dhe me anë të kësaj kontrate kërkohej furnizimi dhe vendosja e tyre, kriteri i AK në lidhje me fuqinë punëtore të nevojshme për zbatimin e kontratës, është hartuar duke vlerësuar nevojën për fuqinë punëtore të nevojshme për transportin dhe montimin e këtyre mallrave. Objekti i procedurës së prokurimit “Blerje orendi dhe pajisje zyre” përfshin në vetvete edhe procesin e prodhimit të mobiljeve pra përmban në vetvete elemente shërbimi për të cilën është e nevojshme që nga ofertuesit të mundshëm ekonomikë të disponohet edhe një staf i cili të bëjë të mundur realizimin me sukses të këtij procesi për realizimin e pajisjeve mobilje. Punonjësit e kërkuar janë të nevojshëm për të asistuar stafin e AK që do të ketë për detyrë procesin e prodhimit apo modifikimeve në rast se do të jetë e nevojshme të mallrave objekt prokurimi. Duke qënë se kjo procedurë prokurimi ka në përbërjen e saj përveç mallrave edhe transportimin dhe instalimin e disa prej tyre e bën të domosdoshëm kërkesën për disponimin nga ana e ofertuesve të mundshëm ekonomikë edhe të një stafi të konsiderueshëm për realizimin në kohën e duhur të lëvrimin dhe instalimit të tyre pranë ambjentëve të Autoritetit Kontraktor. Kriteret për kualifikim vendosen që të shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatën ISO 9001-2015 (ose e përditësuar) mbi sistemin e menaxhimit të cilësisë, e vlefshme dhe e lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar i akreditimit DPA, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave që do të marrë përsipër të realizojë referuar akt-marrëveshjes.

Argumentimi: Ky kriter u vendos në përputhje me parashikimin e nenit 36, nenit 77, nenit 79, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 40 dhe nenit 44, të VKM-se Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit. ISO 9001 parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë e cila mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga furnizuesi, fokusin e klientit, përshtatshmërinë e burimeve të tij, kompetencën/profesionalizmin e punonjësve, procesin e menaxhimit (për prodhim, ofrimin të shërbimeve dhe proceset mbështetëse e administrative), planifikimin e cilësisë, dizenjimi i produkteve dhe shërbimet që ofron, garantimin e një procesi cilësor të furnizimit, sigurimin e konformitetit për mallrat dhe shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e konsumatorëve, veprime korrigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij. Nisur nga rëndësia, volumi i kontratës, rëndësia e Autoritetit kontraktor të përfshirë në këtë procedurë është e rëndësishme me qëllim realizimin me sukses të kësaj procedurë që operatori pjesëmarrës të provojnë se ka një sistem të menaxhimit të cilësisë, pra të demonstrojnë aftësinë e tij për të ofruar vazhdimisht produkte që plotësojnë kërkesat e konsumatorëve pra të Autoritetit Kontraktor dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullative me qëllim të rrisë kënaqësinë e konsumatorit nëpërmjet zbatimit efektiv të sistemit, duke përfshirë proceset për përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit dhe sigurimin e konformitetit ndaj klientit pra Autoritetit Kontraktor . Kërkesa për ISO 9001 është një kërkesë e domosdoshme për të realizuar suksesin e kontratës.

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë fotografi/ katalogët teknikë/ deshmi për rezultatet e testimit zyrtarë, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizma kombëtar ose organizma ndërkombëtar akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, që vërtetojnë pajtueshmërinë e artikujve me specifikimet teknike (sipas përcaktimeve në shtojcën 5) dhe standartet ndërkombëtare ose ekuivalente me të. Këto katalog apo deshmi duhet të jenë të përkthyer e të noterizuara në gjuhën shqipe.

Argumentimi: Ky kriter u vendos në përputhje me parashikimin e nenit 36 dhe nenit 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe VKM-se Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 40 dhe neni 44, pika 1 “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimi.”. Kërkesa për deshmit teknike të kërkuara, test raportet nga autoriteti kontraktor për

mallrat të cilat operatori ekonomik do të ofertojë, në mënyrë që të vërtetohet se këto mallra janë prodhuar sipas standarteve dhe kërkesave të kërkuara në dokumentat standarte të tenderit, është në të drejtë të autoritetit kontraktor, i cili në kriteret e veçanta të kualifikimit të kërkojë dokumentacion provues për të vërtetuar se mallrat i plotësojnë kërkesat e cilësisë.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të lëshojë një deklaratë për periudhën 2 vjecare të garancisë së mallrave që kërkohen të prokurohen nga data e dorëzimit të artikujve objekt prokurimi, gjatë së cilës ofertuesi do të sigurojë riparimin, mirembajtjen dhe shërbimin pa pagesë, të defekteve për shkak të prodhimit dhe montimit.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë se marrin përsipër periudhën e garancisë për mallin e prokuruar. Kjo deklaratë shërben si garanci për Autoritetin Kontraktor që malli objekt prokurimi është në përputhje me specifikimet teknike dhe në rast defekti të ndodhur brenda periudhës së garancisë, të kryhet zëvendësimin ose riparimi i tyre.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të deklarojë që merr përsipër transportin e mallit pranë ambjenteve të Autoritetit Kontraktor brenda afatit të parashikuar.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, neni 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë se do të kryejnë transportin e mallrave objekt prokurimi në adresën e autoritetit kontraktor.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të disponojë minimum 2 (dy) mjete transporti me peshë mbajtëse mbi 1.5 ton të përshtatshëm për transport mallrash. Mjetet e transportit mund të jenë në pronësi ose me qira.

- a) Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë); b) leje qarkullimi; c) çertifikate e kontrollit teknik (e vlefshme); d) siguracion mjeti (i vlefshëm);
 - b) Për mjetet e deklaruara me qera duhet të paraqitet: a) kontrata përkatëse noteriale e qerasë b) dokumenti që verteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë) c) leje qarkullimi; ç) çertifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme) d) siguracion mjeti (i vlefshëm);
- (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetedeklarimit, këto dokumente do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).*

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 4, të nenit 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 8, të nenit 40, të pika 5/ç të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Nëpërmjet këtij kriteri kërkohet që Operatorët ekonomik të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund ti vihen në dispozicion 2 mjetet për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Mjetet e mësipërm janë të domosdoshëm pasi duke marrë në konsideratë vlerën e kontratës që prokurohet, natyrën si dhe kohëzgjatjen e saj i shërben Autoritetit Kontraktor për tu njohur me kapacitetet

teknike të ofertuesve me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses. Duke qënë se kjo procedurë prokurimi ka në përbërjen e saj përvec mallrave edhe transportimin dhe instalimin e disa prej tyre e bën të domosdoshëm kërkesën për disponimin nga ana e ofertuesve të mundshëm ekonomikë edhe të mjeteve të nevojshme për realizimin në kohën e duhur të lëvrimit të tyre pranë ambjenteve të Autoritetit Kontraktor.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike sipas zërave të kërkuar janë si më poshtë:

1. Tavolinë pune në formë L-je + Komodinë (124)

Tavolina e punës: Syprina Melaminë me trashësi 2.5 cm. Veshje laminati me rezistencë të lartë kundër gërvishtjeve dhe njollave. Këmbët janë me planë të të njëjtit material dhe trashësi të syprinës. Bordet anësore të planit të punës dhe të këmbëve të jenë të rrethuara me material plastik PVC. Bashkimi i planit të punës me këmbët bëhet në mënyrë të tillë që i jep tavolinës pamje solide. Pjesa ballore është e pozicionuar e tillë që realizon bashkimin e planit të punës me këmbët e tavolinës dhe qëndron në një hapësirë 40 cm, nga plani i dyshemesë. Në planin e punës të jetë e hapur një vrimë, në të cilën fiksohet një mekanizëm plastik në formë cilindri dhe bën të mundur kalimin e kabllave nga lart poshtë dhe anasjelltas. Këmbët të jenë me mekanizëm. Komodina përbëhet nga 3 sirtarë me rrota lëvizëse, materiali të jetë i njëjtë me tavolinën. Tavolinë pune (gjatësi x gjerësi x lartësi): 180 x 80 x h-72 cm Tavolinë pune (gjatësi x gjerësi x lartësi): 160 x 70 x h-68 cm Komodinë me përmasa: 40 x 60 x h-68 cm.

Të plotësojë kërkesat e standartit SSH EN 527-1:2011, SSH EN 527- 2:2016 + A1:2019 (EN, e njëvlefshme ose e përditësuar), SSH EN 13721:2004.

Foto ilustruese




2. Tavolinë pune + Komodinë (119)

Syprina Melaminë me trashësi 2.5 cm. Veshje laminati me rezistencë të lartë kundër gërvishtjeve dhe njollave. Këmbët janë me planë të të njëjtit material dhe trashësi të syprinës. Bordet anësore të planit të punës dhe të këmbëve të jenë të rrethuara me material plastik PVC. Bashkimi i planit të punës me këmbët bëhet në mënyrë të tillë që i jep tavolinës pamje solide. Pjesa ballore është e pozicionuar e tillë që realizon bashkimin e planit të punës me këmbët e tavolinës dhe qëndron në një hapësirë 40 cm, nga plani i dyshemesë. Aksesorët që përdoren për montimin e elementëve të tavolinës të jenë cilësorë. Në planin e punës të jetë e hapur një vrimë, në të cilën fiksohet një mekanizëm plastik në formë cilindri dhe bën të mundur kalimin e kabllave nga lart poshtë dhe anasjelltas. Këmbët të jenë me mekanizëm nivelues. Tavolinë pune (gjatësi x gjerësi x lartësi): 115 x 70 x 72 cm Komodinë me përmasa: 40 x 60 x h-68 cm

Të plotësojë kërkesat e standartit SSH EN 527-1:2011, SSH EN 527- 2:2016 + A1:2019 (EN, e njëvlefshme ose e përditësuar), SSH EN 13721:2004

Foto ilustruese



3. Karrige rrotulluese zyre

Karriget rrotulluese të kenë shpinore të regjistrueshme me mekanizëm për ulje-ngritje me piston. Mbështetësja prej rrjete si dhe ulësja e rehatshme ofrojnë komoditet gjatë qëndrimit tuaj në karrige. Shpinorja dhe ndenjësja të jenë material plastik i cilësisë së lartë. Lartësia e rregjistrueshme dhe bazamenti i rëndë me pesë rrota. Tapiceria të jetë në stof të cilësisë së parë ose lëkure ekologjike. Karrigia të projektohet në mënyrë që të minimizojnë rrezikun e dëmtimit të përdoruesve

Foto ilustruese



4. Karrige të thjeshta zyre (69)

Karriget të jenë dizenuar me një stil modern. Me skelet metalik prej tubash çeliku me profil oval 30 x 15 mm me spesor jo më të vogël se 1.3 cm me lyerje elektrostatische. Në pjesën e brendshme ndodhet një material plastik i cilësisë së lartë. Shpinorja dhe ndenjësja janë material plastik i cilësisë së lartë. Në pjesën e mbrapme kanë një mbulesë prej polietileni. Montohen në skeleton metalik me vida. Me mbushje gome sintetike me densitet të lartë. Tapiceria të jetë në stof të cilësisë së parë ose lëkure ekologjike. Të plotësojë kërkesat e standartit SSH EN 1335-1:2021, SSH EN 1335-2:2018

Foto ilustruese



5. Karrige statike me krahë mbështetës (71)

Karrigia duhet të jetë me strukturë metalike, bazament mbështetës në formë U, me përmasa ndenjësja 46 cm x 47 cm, shpinorja të jetë në formë të harkuar me përmasa 60 cm x 48 cm. Gjatësia e shpinores duhet të zbresë poshtë nivelit të ndenjësës. Përmasat e bazamentit mbështetës 57 cm x 47 cm. Lartësia totale të jetë 94 cm. Permasat 60 x 40 x 80 cm

Shpinorja dhe ndenjësja duhet të jenë të veshur me lëkurë ekologjike. Të plotësojë kërkesat e standartit SSH EN 1335-1:2021, SSH EN 1335-2:2018

Foto ilustruese



6. Raft për dosje (etazher) (24)

Skeleti dhe Sergjenet do jenë prej materiali melamine me trashësi 16 deri 18 mm. Kapakët janë me material MDF të plastifikuar me PVC me spesor jo më pak se 16 deri 18 mm. Xokula do të jetë 8 cm e lartë dhe prej të njejtit material. Bordet anësore të skeletit, sergjeneve dhe kapakëve të jenë të rrethuara me material plastik PVC. Poshtë fiankeve do ketë tapa fundore kundër gërvishitjes. Në pjesën e poshtme deri në lartësinë 72 cm, do të ketë dy kapakë prej materiali melaminë, me trashësi jo më të vogël se 18 mm që mbyllen me çelës. Dollapi brenda këtyre dy kapakëve do jetë i ndarë në dy pjesë me anë të një sergjene me lartësi të regjistrueshme. Pjesa e sipërme është e mbyllur me kapakë xhami (që mund të jenë me ose pa kornizë druri ose metali). Hapësira brenda kapakëve të xhamit do ndahet në tre hapësira me anë të sergjeneve që janë të regjistrueshëm sipas nevojës. Dorezat dhe aksesorët e përdorur të jenë cilësorë mundësisht prej metali te kromuar. Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi): 90 x 45 x 190 cm.

Të plotësojë kërkesat e Standartit CEN/TR 14073-1:2004, EN 14073-2:2004, EN 14073-3:2004, EN 14074:2004

Foto ilustruese



7. Komodinë zyre (40)

Materiali i përdorur do jetë melamine me trashësi 1.6 deri 1.8 cm. Veshje laminati me rezistencë të lartë kundër gërvishtjeve dhe njollave. Bordet anësore të elementëve përbërës të jenë të veshur me material plastik PVC. Dorezat e kanateve dhe aksesorët e përdorur të jenë cilësorë. Komedine të jetë me sirtare me celes. Përmasat: 45 x 60 x 65 cm.

Të plotësojë kërkesat e Standartit SSH EN 527-1:2011, SSH EN 527-2:2016+A1:2019 (EN, e njëvlefshme ose e përditësuar), SSH EN 13721:2004.

Foto ilustruese



8. Varëse rrobash (Kokë prifti) (144)

Koka duhet të jetë e pajisur me 5 ganxha mbajtëse dhe 5 varëse të harkuara. Diametri rrethor bazamenti mbajtës D: 48-50 cm; Boshti metalik L: 175-180 cm; Diametri i boshtit metalik: minimumi 5 cm; Mbajtëse për çadrat diametri: 27 cm me 4 vende




9. Raft për dosje (etazher) (27)

Skeleti dhe Sergjenet do jenë prej materiali Melaminë me trashësi 2.5 cm. Xokula do jetë 11 cm e lartë, e mbuluar dhe prej të njëjtit material. Bordet anësore të skeletit, sergjeneve dhe kapakëve të jenë të rrethuara me material plastik PVC. Poshtë fiankeve do ketë këmbëza me mekanizëm nivelues, do të ketë dy kapakë prej materiali Melaminë, me trashësi jo më të vogël se 1.8 cm që mbyllen me çelës. Dollapi brenda këtyre dy kapakëve do jetë i ndarë në dy pjesë me anë të një sergjene me lartësi të regjistrueshme. Dorezat dhe aksesorët e përdorur të jenë cilësorë mundësisht prej metali te kromuar.

Përmasat: 126 x 47 x 80 cm.

Të plotësojë kërkesat e Standartit CEN/TR 14073-1:2004, EN 14073-2:2004, EN 14073-3:2004, EN 14074:2004

Foto ilustruese



Argumentim: Në bazë të nenit të 36, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” nenit 15, pika 3/b dhe nenit 40, pika 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar). Specifikimet teknike janë hartuar nga struktura të specializuara/ Grup pune për objektin që prokurohet, i ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike. Specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara si dhe janë në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Në përfundim, Njësia e Prokurimit vendosi unanimisht miratimin e dokumenteve të tenderit dhe si afat përfundimtar për dorëzimin e ofertave. Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit me objekt “Blerje orendi dhe pajisje zyre”. Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurimin anëtar në NJP.